



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:072213

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06638381

C.nr.2284/24

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.H, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Spitali Rajonal Gjilan, me objekt kontesti kompensimi i pagesës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore, me datën 12.12.2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

**HEDHET POSHTË** padia e paditëses A.H, e parashtruar me datë 28.02.2024, kundër të paditurës Spitali Rajonal Gjilan, me objekt kontesti kompensimi i pagesës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri, vlera e kontestit e pa përcaktuar, **si e pa rregulluar**.

#### A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 28.02.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, për kompensimim e pagesës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri, me vlerë të kontestit të papërcaktuar.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendimin e datës 23.04.2024 i ka kthyer në plotësim padinë paditëses, duke e detyruar që të rregullojë petitumin e padisë, duke përcaktuar qartë shumën e kërkuar në emër të kompensimit dhe periudhën kohore për të cilën kërkon të kompensohet, me njoftimin e pasojave procedurale se do të konsiderohet e tërhequr padia nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor (3 ditë), ndërsa nëse i kthehet e pa plotësuar do të hedhet poshtë.

I autorizuari i paditëses, pas pranimit të këtij aktvendimi, ka dorëzuar parashtresën e datës 20.05.2024, në të cilën ka dorëzuar në gjykatë parashtresën në të cilën ka cek se *“E njoftojmë Gjykatën se lidhur me këtë çështje dhe çështje të tjera te ngjashme nuk mund të behët prezicimi dhe saktësimi i kërkesëpadisë për kompensimin e pagave shtese për ditët e punës gjatë vikendeve dhe periudhën kohore/prezencën ne pune te secilit paditës pasi qe për shkak te vlerës se madhe te kontestit e cila duhet te provohet me prova konkrete në raste të tilla kemi propozuar ekspertize*

*financiare me qëllim të konstatimit të sakte të lartësisë së kërkesëpadisë dhe deri me tani praktika gjyqësore ka qene e tille sepse për llogaritjen e kësaj kërkesëpadie duhet ekspert profesional i fushës financiare/ekonomike për qaka i tejkalon njohuritë tona të profesionit të juristit/avokatit. Andaj ne në seancën përgatitorë pas pranimit të përgjigjes ne padi do të kërkojmë nga gjykata që të caktojë ekspert financiar i cili do të marrë të dhënat e nevojshme/evidencat nga e paditura që është e nevojshme për të llogaritur periudhën kohore për të cilën kërkojnë këto lloje të kompensimit, lidhur me kërkesën për kompensimin e pagave shtese për ditët e punës gjate vikendeve dhe Rrezikshmërisë. Andaj pas nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare e rezervojmë të drejtën për precizimin e sakte të kërkesëpadisë, pasi që tani për tani është e pamundur të dihet shuma e sakte e kërkesëpadisë pa nxjerrjen e ekspertizës financiare. Nëse gjykata sipas dispozitës 151 dëshiron të nxjerre një aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, ajo duhet të shikoj nëse janë plotësuar kushtet e parapara me ligj. Kusht elementar për nxjerrjen e aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 152 të LPK është që pala e paditur është përgjigjur në padi. Pra, nuk mund të nxjerre aktgjykim sipas dispozitës së nenit 152 të LPK, nëse pala e paditur nuk është përgjigjur në padi. Kusht tjetër dhe që mund të jete diskutabile, nëse gjykata mund të nxjerre aktgjykim sipas nenit 152 të LPK, kur nuk i ka pohuar faktet, por as nuk i ka mohuar ato. Duke u nisur nga interpretimi gjuhësor i dispozitës së nenit 152 të LPK, do të mund të arrihet në përfundim se gjykata mund të nxjerre aktgjykim sipas nenit 152 të LPK, vetëm nëse pala e paditur i ka pohuar faktet, e prezantuar nga ana e palës paditëse, por në këtë rast i ka kundërshtuar ato. Kusht tjetër për nxjerrjen e aktgjykimit, në bazë të nenit 152 të LPK, është, se pala e paditur në përgjigjen ndaj padisë i ka pohuar faktet, por e ka kundërshtuar kërkesëpadinë. Nëse pala e paditur ka pohuar edhe faktet dhe ka pohuar edhe kërkesëpadinë, atëherë gjykata në këtë rast do të nxjerre aktgjykim në bazë të pohimit, sipas dispozitës së nenit 148 të LPK. ( Në nuk kemi pranuar përgjigje në padi me të cilën e paditura i ka pohuar faktet por e paditura edhe në përgjigjen sipas kërkesës tone ajo i ka mohuar faktet dhe kërkesat e paditësit/ses). Prandaj, nuk mund të nxjerre aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, nëse nuk ka : Pohim të fakteve të çështjes nga ana e te paditurit derisa në përgjigjen e kërkesës tone kemi mohim të fakteve tona e paditura sa i përket kërkesave të paditësit. Po ashtu nuk mund të nxjerre aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, nëse kemi të bëjmë me kërkesa për të cilat palët nuk mund të disponojnë lirisht në kuptim të nenit 3 par 3 të LPK. E kemi paguar edhe taksen e gjykatës sipas vlerës së pacaktuar, të cilën gjate procedurës pas pranimit të ekspertizës dhe precizimit të padisë do të paguajmë taksen shtesë. Ne kemi provuar ti sigurojmë provat dhe ti bashkëngjisim në padi, por pasi ato gjenden tek e paditura, kërkojmë nga Gjykata e nderuar që të veproj sipas nenit 332 dhe 333 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ose Eksperti Financiar i siguron nga e paditura me rastin e përpilimit të ekspertizës financiare”.*

Pas shqyrtimit të parashtresës, gjykata gjeti se i autorizuari i paditësit nuk ka vepruar në kuptim të aktvendimit për plotësimin e padisë, përkatësisht nuk e ka bërë plotësimin e parashtresës - padisë, sipas vërejtjeve - sugjerimeve si në aktvendimin e cekur më lartë, duke u njoftuar edhe për pasojat ligjore në rast të mos veprimit, pra parashtresa e dorëzuara nga ana e paditësit nuk e përmban kushtin e formës së shkruar si dhe çdo gjë që nevojitet që ta mundëson veprimin sipas saj.

Andaj, gjykata nga arsyet e cekura si me lartë e duke u mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 102.1 të LPK, ku parashihet se kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë siç kërkohet në par. 2 të nenit 99, gjykata do të thërras personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë, gjykata udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet dhe e cakton një periudhë 3 ditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës, ndërsa me dispozitën ligjore nga neni 102.3 të LPK-së, parashihet se do të konsiderohet e tërhequr parashtrësja, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në çoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hedhet poshtë.

Më dispozitat e nenit 142 të LPK -së, përcaktohet shprehimisht se: “Gjykata jep vendime në seancë apo jashtë seance. Vendimet e gjykatës jepen në formë të aktgjykimit apo aktvendimit. Për të gjitha çështjet tjera gjykata vendos me anë të aktvendimit”.

Gjykata me rastin e vendosjes, vlerësoj edhe parashtrësën e të autorizuarit të paditëses të quajtur plotësim i parashtrësës, mirëpo edhe me plotësimin e parashtrësës nuk është rregulluar kërkesa (petitumi) i padisë sipas udhëzimeve të gjykatës. Në këtë parashtrësë me të cilën pretendohet se është bërë precizimi i kërkesëpadisë sa i përket “*kërkesave për punë gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri*”, pavarësisht kësaj nuk është precizuar kërkesa sa i përket shumës së kërkuar gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri dhe periudha kohore se nga cila datë deri në cilën datë kërkohet kjo shumë, sepse jo domosdoshmërisht është e nevojshme marrja e provës me ekspertize financiare për të përcaktuar vlerën e kontestit, rrjedhimisht e paditura duhet të ketë para vetes një kërkesë të qartë në mënyrë që të deklarohet për të, andaj nën këto rrethana sipas vlerësimit të gjykatës kjo çështje nuk mund të procedohet tutje.

Bazuar në këtë dhe në mbështetje të dispozitave nga neni 99, 102, 390 e lidhur me nenin 387, e lidhur me nenin 142 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
C.nr.2284/24, datë 12.12.2024

**Gjyqtari,**  
Berat Spahiu

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.